



Pranuar / Dorezuar Prunhem/Protado Received/Delivery	28.04.2023	3	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Dr Prof Dr Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kopjime Quantity
SKPM/SAICA	3953/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.518/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.518/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim i përfaqëson avokat

me adresë

kundër organit të punësimit/Ministritsë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.518/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.07.2017 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Mbrojtjes së Natyrës", ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 10.10.2014 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit", ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2015 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Mbrojtjes së Ujërave", ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2015 është e punësuar në pozitën "Inspektore e Mbrojtjes së Mjedisit", ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 10.02.2014 është i punësuar në

pozitën “Inspektor për Mbrojtjen e Ujërave”, ankuesi _____ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 18.11.2013 është i punësuar në pozitën “Kryeinspektor”, ankuesja _____ sipas Akt Emërimit të datës 05.01.2015 është e punësuar në pozitën “Inspektore e Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor”, ankuesi _____ në bazë të Akt Emërimit të datës 05.01.2015 është i punësuar në pozitën “Inspektor për Mbrojtjen e Mjedisit”, ankuesi _____ sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 01.07.2020 është i punësuar në pozitën “Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit”, ankuesja _____ sipas Akt Emërimit të datës 26.01.2015 është e punësuar në pozitën “Inspektore e Ndërtimit dhe Planifikimit” dhe ankuesi _____ sipas Akt Emërimit të datës 03.03.2014 është i punësuar në pozitën “Inspektor i Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor” të gjithë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje sipas provave të lëndës, ankuesit më datën 28.02.2023 Kryeinspektori i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë parashtruar kërkesë me numër protokoli 972/23 tek Udhëheqësi i Divizionit të Personelit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes të cilët kanë kërkuar kompensimin e shtesës në pagë në emër të kushteve specifike të punës respektivisht rrezikshmërisë në punë, mirëpo në bazë të provave të lëndës nuk kanë marr përgjigje.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre, më datë 16.03.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokoli 2727/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me pretendimet ankimore për kompensim material respektivisht shtesës së rrezikshmërisë sipas legjislacionit përkatës në fuqi në mënyrë retroaktive nga data 06.11.2013 deri më datë 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Ministria e Mjedisit, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli më datë 04.04.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokoli 2727/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me Nr. Port: 1304/15 e datës 24.03.2023 e parashtruar nga Inspektorët për Ministrinë e MMPH-së; Kërkesën e datës 08.02.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së për Sekretarin e Përgjithshëm të MAP; Kërkesën me Nr. Port: 4980/22 e datës 31.08.2022 e parashtruar nga ankuesi tek Zv. Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së; Kërkesë për kompensim të kushteve specifike nga _____ Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin _____ Dokument identifikimi për ankuesin _____ Akt Emërimit të datës 03.07.2017 për ankuesin _____ Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin _____ Akt Emërimit të datës 10.10.2014 për ankuesin _____ Dokument identifikimin për ankuesin _____ Akt Emërimit të datës 05.03.2015 për _____ Dokument _____

identifikimin për ankuesin Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin Akt Emërimin e datës 01.07.2015 për ankuesen Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin E.Sh; Akt Emërimin e datës 10.02.2014 për ankuesin ; Dokument identifikimin për ankuesin ; Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin Akt Emërimin e datës 18.11.2013 për ankuesin Dokument identifikimin për ankuesin Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesen Akt Emërimin e datës 05.01.2015 për ankuesen ; Dokument identifikimi për ankuesen Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin Kontratë e marrëdhënies së punës për ankuesin Dokument identifikimi për ankuesin Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin ; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.07.2020 për ankuesin ; Dokument identifikimin për ankuesin Sh.N; Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesen , Dokument identifikimi për ankuesen Vërtetimin e datës 06.03.2023 për ankuesin , Akt Emërimin e datës 03.03.2014 për ankuesin Dokument identifikimin për ankuesin ; Autorizim për shërbime ligjore i datës 13.03.2023; Kërkesën për përgjigje ne ankesë e datës 28.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 04.04.2023; Emailin e datës 01.03.2023 nga për KSHKSP; Listën e pagave e muajit shkurt për ankuesit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 17.04.2015 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së mjedisit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 30.02.2016 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së Natyrës; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 02.06.2014 për pozitën Inspektor i Planifikimit dhe Ndërtimit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 13.03.2014 për pozitën Kryeinspektor i MMPH-së; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 17.04.2015 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së ujërave; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 13.03.2014 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së ujërave; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 10.09.2014 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së mjedisit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 17.04.2015 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së mjedisit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 17.04.2015 për pozitën Inspektor i Planifikimit dhe Ndërtimit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 17.04.2015 për pozitën Inspektor i mbrojtjes së mjedisit; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 13.03.2014 për pozitën Inspektor i Planifikimit dhe Ndërtimit; Kërkesën me numër protokolli 972/23 të datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesve, *është e jashtëafatshme, sepse:*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pretendojnë që institucioni ku punojnë asnjëherë nuk ka bërë kompensim të shtesës në pagë në emër të kushteve specifike të punës respektivisht rrezikshmërisë sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera të Nëpunësve Civil si dhe nuk ka bërë pajisjen me veshmbathje stinore për ushtrimin e detyrës sipas Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, duke kërkuar që ankesa të aprovohet në tersi, dhe të bëhet kompensimi material respektivisht shtesës së rrezikshmërisë sipas legjislacionit përkatës në fuqi në mënyrë retroaktive nga data 06.11.2013 deri më datë 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve, konstaton se ankuesit fillimisht kërkesën e parë lidhur me këtë çështje e kanë parashtruar më datë 24.03.2015 tek Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, pastaj më datë 08.02.2016 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike për kompensimin e shtesë mbi pagën bazë për ankuesit, kurse ankuesit kërkesën e fundit tek institucioni e kanë parashtruar më datë 31.08.2022.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit lidhur me kërkesën e datës 31.08.2022 kanë parashtruar ankesë më datë 11.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.889/2022 të datës 22.11.2022 ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesve për shkak që ankuesit kanë parashtruar ankesën në Këshilli ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 31.08.2022 në kuptim të afateve të shqyrtimit të kërkesës sipas Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*".

Duke u bazuar në këtë, meqenëse ankuesit më datë 11.10.2022 kanë parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërlihur me kërkesën së datës 31.08.2022, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesit në ankesën e datës 16.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që nuk janë shqyrtuar kërkesat e tyre e ndër to edhe kërkesa e datës 31.08.2022, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton ankuesit ndaj heshtjes administrative ndaj kërkesës së tyre të fundit respektivisht atë të datës 31.08.2022 të parashtrojnë ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me afatet e përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativo..."* ngase në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankuesit në raport me kërkesën e datës 31.08.2022 ankesën e datës 16.03.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e kanë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitën e cekur si më lartë. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesve është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji"*.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.518/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat.
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.